



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 770 Prot.

Shkodër, më 21. 02. 2025

V E N D I M

Nr. 52, datë 21.02.2025

"PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nen 33; Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", nen 86 dhe 87: sugjerimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 7511/I prot, datë 03.02.2025, protokolluar në Rektorat me nr. 499 prot, datë 05. 02. 2025, në kuadër të domosdoshmërisë për plotësimin e procedurës për kryerjen e ndryshimeve në Statut, procedurë kjo e iniciuar me Vendimin e BA nr. 270, datë 26.11.2024 "Për miratimin e organigramës si pjesë integrale e Statutit të USH-së" dhe Vendimi i Senatit Akademik nr. 272 , datë 27. 11. 2024 "Për miratimin e ndryshimit të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", me shtimin e organigramës si shtojcë të tij", Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 21. 02. 2025;

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", si më poshtë vijon:

- Në nenin 8 të Statutit të USH-së, të shtohet pika 3, me këtë përbajtje: *Organigrama e USH-së, përcaktohet në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij statuti.*
- Në pikën 5, të nenit 9, të Statutit të USH-së, emërtimi: (Fakulteti i Shkencave Natyrore), korrigohet dhe unifikohet në: *(Fakulteti i Shkencave të Natyrës).*
- Pika 6, e nenit 9, i Statutit të USH-së, të riformulohet si vijon: *Përbërja e fakulteteve përcaktohet në shtojcën 1, bashkëlidhur statutit dhe në rregulloret e tyre.*

2. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

3. Ky vendim hyr në fuqi menjëherë.





STATUTI I

UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

Shkodër, Shkurt 2025

Miratuar ndryshimi me Urdhër të MAS, nr. 131, datë 02.04.2025

Përbajtja e lëndës

KREU I	
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	3
KREU II	
ORGANIZIMI I USH-së	6
KREU III	
DREJTIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I USH-së	9
KREU IV	
AUTORITETET DREJTUESE	18
KREU V	
PERSONELI I UNIVERSITETIT	26
KREU VI	
ORGANIZIMI I STUDIMEVE	30
KREU VII	
KËRKIMI SHKENCOR	35
KREU VIII	
AUTONOMIA FINANCIARE	36
KREU IX	
MARRËDHËNIET MË JASHTË	38
KREU X	
VEPRIMTARIA BOTUESE	38
KREU XI	
STUDENTËT	38
KREU XII	
CEREMONITË	41
KREU XIII	
EMRI, VULA DHE STEMA ZYRTARE	41
KREU XIV	
MIRATIMI DHE RISHIKIMI I STATUTIT	42
KREU XV	
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT	42

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Hartimi dhe përbajtja

- 1.** Statuti i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (shkurt USH) është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (shkurt LAL) dhe aktet nënligjore në fuqi, dhe është zbatim konkret i këtij ligji, si dhe gjithë legjislacionit tjeter në fuqi për arsimin e lartë.
- 2.** Statuti përmban normat bazë që përcaktojnë organizimin e USH-së, riorganizimin e strukturimin e brendshëm akademik dhe administrativ të USH-së dhe të programeve të studimit në bazë të ligjit LAL.
- 3.** Statuti i USH-së përcakton në mënyrë të detajuar: organizimin, strukturat përbërëse të USH-së, njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësitë ndihmëse; organet dhe autoritetet drejtuese të USH-së, funksionet e kompetencat dhe mënyrën e formimit dhe funksionimit të tyre.
- 4.** Statuti përban normat kryesore që rregullojnë: veprimtarinë dhe punën e USH-së, veprimtarinë e strukturave dhe njësive përbërëse, të organeve dhe të autoriteteve drejtuese: zgjedhjen ose dëshrimin e tyre; nivelet e delegimit të autoritetit nga organet drejtuese tek autoritetet administruese; periudhën e kryerjes së vlerësimit të programeve të studimit dhe të auditimit të brendshëm të veprimitarës së strukturave; detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, joakademik dhe të studentëve, si dhe aspektet tjerat të veprimitarës së këtij institucioni.
- 5.** Statuti detyron njësitë përbërëse dhe organet e USH-së të hartojnë rregulloret e tyre të brendshme në përputhje me LAL dhe në përputhje me përcaktimet e bëra në statut. Rregulloret hartoohen dhe miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të USH-së.

Neni 2

Pozita juridike

- 1.** Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është Institucion Publik i Arsimit të Lartë (IPAL) në RSH, i njojur me ligj si i tillë. Veprimitaria e Universitetit bazohet në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, në këtë Statut dhe në rregulloret që miratohen, në zbatim të tyre.
- 2.** Universiteti i Shkodrës është person juridik publik që financohet nga Buxheti i Shtetit ose vetëfinancohet nga burime të tjera të ligjshme. USH përfaqësohet nga Rektori për çështjet akademike dhe protokollare dhe nga administratori për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të LAL-së.

Neni 3

Themelimi dhe selia e USH-së

- 1.** Universiteti i Shkodrës u krijuua me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 167, datë 28 maj 1991, mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik, i hapur më 3 shtator 1957, që konsiderohet edhe data e krijimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe që festohet si data e themelimit të tij.
- 2.** Selia qendrore e USH është godina e Rektoratit me adresë Sheshi “2 Prilli” Shkodër. Selitë e njësive kryesore përbërëse të USH-së përcaktohen me vendim të Senatit akademik.
- 3.** Stema dhe vula e Universitetit të Shkodrës përcaktohen nga Senati Akademik dhe janë të pasqyruara në anekset bashkëlidhur këtij statuti: vula modeli 1 dhe stema modeli 2.

Neni 4

Misioni

1. Universiteti i Shkodrës ka si mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimjn fizik dhe sportet. Gjithashtu, USH ka si mision të formojë specialistë të lartë dhe të përgatitë shkencëtarë të rinj.
2. USH ka për detyrë të japë njojuri bazë me metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të caktuar profesionesh dhe specialitetesh, sipas fushave që mbulon, si dhe të sigurojë arsimim dhe kualifikim të mëtejshëm profesional e shkencor.
3. USH ushton funksionet themelore të kërkimit shkencor dhe të didaktikës për çdo tip formimi të nivelit të lartë, duke përfshirë orientimin, formimin e përhershëm dhe përditësimin kulturor e profesional, veprimtaritë bazë apo plotësuese për to, si dhe kërkimin e aplikuar për problemet me interes publik apo privat.
4. USH ka për detyrë të plotësojë standartet për të garantuar zhvillimin mësimor e atë shkencor në tri ciklet e studimit që ofron.
5. USH ka për detyrë të ndihmojë dhe të mbështesë zhvillimin kulturor e social - ekonomik në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke promovuar, organizuar dhe kryer shërbime kulturore dhe formuese.

Neni 5

Autonomia

1. USH është institucion publik i arsimit të lartë. Ai është autonom. Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" USH gjzon: autonomi organizative / administrative; autonomi financiare dhe autonomi në përzgjedhjen e personelit.
2. Autonomia organizative/administrative e USH-së garantohet nëpërmjet të drejtës:
 - a) për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organet dhe autoritetet drejtuese;
 - b) për të organizuar strukturat e brendshme përbërëse dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me LAL dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi;
 - c) për të caktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit;
 - d) për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore-shkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera të ligjshme;
 - e) për t'u anëtarësuar në shoqata / organizata kombëtare ose ndërkombëtare që operojnë në fushën e arsimit të lartë.
3. Autonomia financiare e USH-së garantohet nëpërmjet së drejtës:
 - a) për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) për të përsituar fonde nga shteti dhe organizma të tjera;
 - c) për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit;
 - d) për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me LAL-në;
 - e) për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që institucioni zoteron ligjërisht,

në përputhje me misionin e tij.

4. Autonomia për përzgjedhjen e personelit të USH-së garantohet përmes të drejtës:

- a) për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij,
- b) për të përcaktuar pagat e personelit.

**Neni 6
Liria akademike**

1. USH gëzon liri akademike në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor.

2. Liria akademike qëndron në respektimin e opinioneve, të ideve, metodave dhe në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

3. Liria akademike dhe liria e kërkimit shkencor garantohet nëpërmjet:

- a) lirisë për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, përmes lirisë së plotë për hartimin dhe zhvillimin e programeve të studimit dhe lirisë së stafit akademik për hartimin e programeve të lëndëve që zhvillohen në USH;
- b) lirisë së USH-së dhe lirisë së personelit akademik të USH-së për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe lirisë së USH-së dhe të personelit akademik për të organizuar dhe realizuar veprimtarinë kërkimore-shkencore, të inovacionit dhe veprimtarinë krijuese;
- c) lirisë së USH-së për të organizuar dhc rregulluar procesin e promovimit të personelit akademik në përputhje me LAL-në dhe aktet e tjera nënligjore.

**Neni 7
Paprekshmëria**

1. Shteti i garanton USH-së paprekshmërinë e institucionit dhe të territorit dhe laicitetin e mospërdorimin e simboleve fetare.

2. USH ruan neutralitet politik.

3. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset e USH-së bëhet vetëm me kërkesën ose lejen e Rektorit.

4. Lejohet ndërhyrja e organeve të rendit publik pa lejen e Rektorit vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant / e një vepre penale flagrante dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore dhe gjendjes së jashtëzakonshme. Pas ndërhyrjes, këto organe janë të detyruara të njoftojnë menjëherë Rektorin.

5. Për çdo cënim të paprekshmërisë së USH-së Rektori kërkon ndëshkim, sipas dispozitave ligjore.

KREU II



ORGANIZIMI I USH-SË

Neni 8 Njësitë e USH-së

USH për realizimin e misionit të vet dhe të veprimitarës mësimore, kërkimore-shkencore është i organizuar në këto njësi përbërëse:

- a) Njësi kryesore / Fakultetet / Institutet kërkimore-shkencore;
 - b) Njësi bazë / departamentet / qendrat kërkimore shkencore;
 - c) Njësi ndihmëse akademike dhe administrative.
2. Njësitë përbërëse të USH-së gjëzojnë autonomi:
- a) në nxjerrjen e akteve rregulluese;
 - b) në ushtrimin e funksionit të vet;
 - c) në krijimin dhe shpenzimin e të ardhurave financiare, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Statut dhe në rregulloret e USH-së.
3. Organigrama e USH-së, përcaktohet në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij statuti.

Neni 9 Njësitë kryesore

1. Njësi kryesore të USH-së janë fakultetet. Fakulteti është njësi kryesore e përbërë së paku nga tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente.
2. Fakulteti është njësia kryesore e USH-së që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërtë ose të ndërthurura dhe ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme në përfundim të të cilave lëshon diplomën përkatëse.
3. Fakulteti miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi. bazuar në propozimet e njësive bazë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore.
4. Organizimi dhe funksionimi i fakulteteve përcaktohet në rregulloren e fakultetit të miratuar nga asamblea e personelit akademik të fakultetit me 2/3 e votave në përputhje me LAL-në dhe këtë Statut.

5. USH ka në përbërjen e tij gjashtë fakultete:

- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Fakultetin e Shkencave Shoqërore;
- Fakultetin e Drejtësisë;
- Fakultetin Ekonomik;
- Fakultetin e Gjuhëve të Huaja;
- Fakultetin e Shkencave të Edukimit.

6. Përbërja e fakulteteve përcaktohet në shtojcën 1, bashkëlidhur statutit dhe në rregulloret e tyre.

Neni 10 Instituti kërkimore-shkencor

1. Instituti kërkimore-shkencor, kryen veprimitari kërkimore- shkencore, zhvillimi dhe inovacioni.
2. Instituti mbështet realizimin e programeve të ciklit të dytë dhe të tretë, kur programet ofrohen

nga njësi të tjera kryesore të USH-së.

3. Struktura e institutit, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i tij përcaktohen në rregulloren e Institutit të miratuar nga Senati i USH-së.

Neni 11
Departamenti

 Njësi bazë të USH-së janë:

a) departamentet;

b) qendrat kërkimore-shkencore.

2. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërtë dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore.

3. Departamenti mund të krijohet edhe nga fakultete të ndryshme të USH-së për organizimin dhe realizimin e programeve të studimit me karakter ndërdisiplinor. Në këto raste, funksionimi dhe varësia e këtij departamenti përcaktohen në Statutin e USH-së. Departamenti funksionon duke u bazuar në rregulloren e vet të miratuar nga departamenti dhe të nënshkruar nga dekanët e fakulteteve përkatëse. Varësia e departamenteve ndërdisiplinore përcaktohet në vendimin e themelimit.

4. Departamenti përbëhet nga të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë.

5. Në përbërjen e departamenteve mund të përfshihet edhe personel ndihmës – akademik me karakter mësimor.

6. Departamenti zgjedh drejtuesin e tij. Për postin e drejtuesit të departamentit kanë të drejtë të kandidojnë individët të cilët plotësojnë kriteret që përcakton LAL dhe rregullorja e zgjedhjeve. Ato duhet të kenë vjetërsi pune jo më pak se 5 vjet në arsimin e lartë.

7. Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimore-shkencor, në përputhje me llojin dhe misionin e institucionit.

8. Departamenti ka këto kompetenca:

a) harton programet e studimit dhe i propozon për miratim në Senatin Akademik;

b) miraton programet e lëndëve dhe planet kalendare;

c) miraton shpërndarjen e ngarkesës mësimore të pedagogëve të departamentit;

d) miraton raportin e vlerësimit të brendshëm të departamentit;

e) miraton programin e provimit të diplomës që ofron;

f) miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe shkencore të departamentit;

g) harton rregulloren e departamentit dhe e dërgon për miratim nga dekanati i fakultetit.

9. Departamenti propozon numrin dhe kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi që ofron, në përputhje me përcaktimet e LAL-së dhe të akteve nënligjore. Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore.

10. Departamenti mund të ofrojë shërbime për të tretë, si dhe të zhvillojë veprimtaritë tjera, sipas legjisacionit në fuqi dhe rregullave të përcaktuara në Statut dhe aktet e tjera të USH-së.

11. Departamenti menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare.

12. Në ushtrim të funksioneve të veta departamenti shprehet me vendime.

Neni 12 **Qendra kërkimore-shkencore**

1. Pranë ~~fakulteteve~~ të USH-së mund të krijohen qendra kërkimore-shkencore si njësi bazë që kryejnë veprimitari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi.
2. Qendra kërkimore – shkencore përbëhet nga jo më pak se 7 anëtarë. Drejtori i qendrës zgjidhet me shumicën e votave të asamblesë së anëtarëve të punësuar me kohë të plotë.
- ~~3. Qendra kërkimore-shkencore ka këto kompetenca:~~
 - a) harton programet e kërkimit shkencor dhe i propozon për miratim në Senatin Akademik;
 - b) miraton programin e kërkimit shkencor të anëtarëve të qendrës;
 - c) miraton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të qendrës kërkimore – shkencore për çdo vit akademik;
 - d) miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe shkencore të qendrës kërkimore-shkencore;
 - e) miraton rregulloren e qendrës kërkimore-shkencore.
4. Në ushtrim të funksioneve të veta qendra kërkimore-shkencore shprehet me vendime.

Neni 13 **Njësitë dhe mjediset ndihmëse**

1. Njësi dhe mjedise ndihmëse në USH janë:
 - a) njësitë administrative;
 - b) laboratoret;
 - c) biblioteka/t;
 - d) palestra dhe mjediset sportive;
 - e) njësitë teknike dhe të tjera.
2. Njësitë ndihmëse të USH-së përcaktohen në strukturën organizative të USH-së, që miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.
3. Funksionimi dhe administrimi i njësive ndihmëse përcaktohet në rregullore të veçanta, të cilat miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.
4. Drejtuesit e njësive ndihmëse në USH emërohen nga Rektori ose Administratori në bazë të rregullores "Për zënien e ruajtjen e vendit të punës" në bazë të LAL-së dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 14 **Degët e institucioneve të arsimit të lartë**

1. USH ka të drejtë të hapë degë në Republikën e Shqipërisë për të ofruar programe studimi dhe për të zhvilluar kërkim shkencor, veprimitari trajnuese, shërbime dhe veprimitari të tjera, në përputhje me kompetencat dhe fushën e veprimtarisë së tij.
2. Degë e USH-së mund të jetë:
 - a) një njësi e veçantë në strukturën e USH-së si njësi kryesore ose njësi bazë;
 - b) pjesë përbërëse e njësive të selisë qendrore të USH-së.
3. Degët e USH-së dhe programet e studimit, që ofrohen në to, u nënshtronen kritereve dhe procedurave të vlerësimit dhe të akreditimit, sipas përcaktimeve të LAL-së.

KREU III

DREJTIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I USH-SË

Neni 15

Organet kolegjiale në USH

1. Organet kolegjiale në USH janë:

- a) Asambleja e personelit akademik
- b) Senati Akademik
- c) Komisionet e përhershme.
- d) Rektorati
- e) Dekanati
- f) Bordi i Administrimit
- g) Këshilli i Etikës

2. USH ka të drejtë të krijojë në strukturën e vet organe të tjera, në përputhje me misionin dhe veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve në Statut.

Neni 16

Asambleja e personelit akademik

1. Asambleja e personelit akademik e USH-së përbëhet nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në njësitë kryesore të USH-së. Asambleja e personelit akademik zgjedh rektorin e USH-së.

2. Asambleja e personelit akademik e njësisë kryesore përbëhet nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në njësinë përkatëse kryesore të USH-së. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore:

- a) zgjedh anëtarët e Senatit Akademik të USH-së;
- b) zgjedh drejtuesin e njësisë kryesore / dekanin e fakultetit;
- c) krijon komisionet e përhershme të njësisë kryesore;
- d) zgjedh anëtarët e komisioneve të përhershme të njësisë kryesore.

3. Asambleja e personelit akademik mund të ushtrojë edhe kompetenca të tjera, sipas përcaktimeve në statutin e USH-së.

Neni 17

Senati

1. Senati është organi më i lartë akademik i USH-së. Senati është organ kolegjal akademik që është përgjegjës për përbushjen e misionit të USH-së si institucion i arsimit të lartë.

2. Senati Akademik i USH-së kryesohet nga Rektori.

3. Senati Akademik mblidhet periodikisht, si rregull, një herë në muaj.

4. Numri i anëtarëve dhe përfaqësimi i njësive kryesore në Senatin Akademik të USH-së përcaktohen me vendim të Senatit pas shpalljes së zgjedhjeve të reja.

5. Zgjedhja e anëtarëve të Senatit Akademik bazohet në aktet nënligjore dhe statut.

6. Senati Akademik ka këto funksione kryesore:

- a) garanton autonominë e USH-së, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
- b) miraton planin strategjik të zhvillimit të USH-së dhe ia propozon Bordit të Administrimit;

- c) miraton me shumicën e votave të anëtarëve të tij planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të USH-së dhe ia propozon Bordit të Administrimit;
 - c) miraton ndarjen e burimeve financiare;
 - d) ~~hariton~~ strukturën e përgjithshme të USH-së dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit në të gjitha nivelet;
 - ~~dh)~~ ~~miraton~~ raportin për veprimtarinë financiare të USH-së në gjysmën e vitit buxhetor (korrik) dhe në fund të vitit buxhetor (janar) me shumicën e gjithë anëtarëve;
 - e) ~~miraton~~ statutin e USH-së me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
 - f) miraton programet e reja të studimit dhe të kërkimit shkencor, ndryshimet dhe mbylljet e tyre. I propozon MASR-it hapjen e programeve të reja të studimit në USH;
 - g) miraton ndryshimet profilizuese deri në masën 20 për qind të programeve të studimit të akredituara. Për këto njoftohet MASR jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik;
 - gj) miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të USH-së mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;
 - h) vlerëson dhe garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në USH;
 - i) vlerëson veprimtarinë mësimore-kërkimore të personelit akademik;
 - j) miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
 - k) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimitarës së USH-së, të hartuar nga rektorati dhe ia përcjell atë MASR-it;
 - l) zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit;
 - ll) organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiar;
 - m) siguron që zhvillimi i provimeve të bëhet në përputhje me standardet e arsimit të lartë, duke garantuar cilësinë dhe transparencën e duhur;
 - n) i propozon MASR kuotat e pranimeve në USH;
 - nj) propozon tarifat e regjistrimit, shkollimit dhe shërbimeve, sipas propozimeve të njësive bazë.
 - o) miraton kriteret e pranimit për kandidatët në të tri ciklet e studimeve, sipas propozimeve të njësisë bazë;
 - p) miraton paraprakisht hapjen e degëve dhe krijimin e qendrave apo kurseve të posaçme, si dhe projekteve të tjera të shërbimit që ofrohen nga njësítë bazë, bazuar në propozimin e këtyre të fundit;
 - q) miraton rregulloren e brendshme të tij;
 - r) miraton rregulloret e USH-së dhe aktet e tjera, sipas përcaktimeve të bëra në Statut;
7. Nga anëtarët e tij, Senati Akademik zgjedh sekretarin dhe nënkyryetarin, statusi i të cilit përcaktohet në rregulloren e brendshme të Senatit akademik;
8. Senati Akademik i USH-së organizohet në komisione të përherershme:
- a) Komisioni i kurrikulave, kërkimit shkencor dhe botimeve;
 - b) Komisioni i marrëdhënieve me jashtë;
 - c) Komisioni i statutit, i rregulloreve dhe i disiplinës;
 - d) Komisioni i ekonomisë dhe i burimeve njerëzore.

9. Anëtarët e Senatit Akademik të USH-së zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësive kryesore, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat 4- vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar.

10. Anëtarët e senatit të USH-së i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet e nungesës së autoriteteteve drejtuese me këtë titull, përfektivisht, kategoria e tyrozibret deri në gradën shkencore “Doktor”. Anëtar senati zgjidhet personeli akademik që ka një vjetërsi 10 vite pune si pedagog në arsimin e lartë.

11. Në Senatin Akademik të USH-së përfaqësohen edhe studentët në masën dhjetë për qind.

12. Mandati i anëtarit të Senatit merr fund kur:

- a) përbushet afati i mandatit;
- b) jep dorëheqjen;
- c) largohet nga USH ose humb statusin e studentit;
- d) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
- e) nuk merr pjesë, për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit akademik;
- f) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

13. Plotësimi i vendit të mbetur vakant në Senatin Akademik bëhet duke u marrë emri në renditje zbritëse nga lista e kandidatëve të zgjedhjeve të fundit. Kur nuk ka mbetur asnjë kandidat zhvillohen zgjedhje duke u bazuar në aktet nënligjore në fuqi.

14. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Senatit akademik, kuromi, votimi, shumicat për marrjen e vendimeve dhe çështjeve të tjera të lidhura me to parashikohen në rregulloren e brendshme të Senatit Akademik të USH-së.

Neni 18 **Komisionet e përhershme**

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegiale të USH-së me funksione akademike.

2. Komisionet e përhershme që krijohen në USH janë:

- a) Komisioni për kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik;
- b) Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit;
- c) Komisioni që mbikëqyr mbarëvajtjen e veprimitarisë së USH-së dhe marrëdhëniet me studentët;
- d) Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.

3. Komisionet e përhershme krijohen në nivel të USH-së dhe në nivel të njësisë kryesore.

4. Senati përcakton numrin e anëtarëve të komisioneve të përhershme të USH-së dhe të njësive kryesore. Anëtarët e komisioneve të përhershme të USH-së përbëhen nga të paktën një përfaqësues për çdo njësi kryesore. Ata vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik i USH-së për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

5. Anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore përbëhen nga të paktën një përfaqësues për çdo njësi bazë. Ata vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore të USH-së midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

6. Në përbërje të këtyre komisioneve të përhershme studentët përfaqësohen të paktën me një anëtar, me përjashtim të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” dhe Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.

Neni 19

Komision i pérhershëm për kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik

1. Komision i pérhershëm për promovimin akademik krijohet dhe funksionon kur plotësohet numri minimal i anëtarëve i përcaktuar nga LAL. Ai është organ akademik kolegjial, i cili përbihet nga pedagogë me kohë të pëlqitur në USH-së, që kanë titullin "Profesor".

2. Senati Akademik përzgjedh nga personeli akademik i njësive kryesore anëtarët e Komisionit për promovimin e personelit akademik. Ata mbajnë titullin "Profesor". Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Titujt akademikë që fitohen në USH janë: "Profesor" dhe "Profesor i asociar".

3. Komision i Pérhershëm për Promovimin e Personelit Akademik kryesohej nga rektori i USH-së, i cili thërret mbledhjen e parë të Komisionit.

4. Komision i Pérhershëm për Promovimin e Personelit Akademik harton rregulloren e funksionimit të vet, e cila miratohet nga Senati Akademik i USH-së.

Neni 20

Titujt akademikë

1. Për fitimin e titullit "Profesor" në USH, mund të aplikojë personeli akademik i USH-së që gjëzon prej së paku pesë vjetësh titullin "Profesor i asociar" dhe që përmbush standardet shtetërore përfitimin e titullit.

2. Për fitimin e titullit "Profesor i asociar" në USH, mund të aplikojë personeli akademik i USH-së që gjëzon gradën shkencore "Doktor", prej së paku pesë vjetësh, është personel akademik i kategorisë "Lektor" dhe përmbush standardet shtetërore përfitimin e titullit.

3. Për fitimin e titullit "Profesor" dhe "Profesor i asociar" në USH, mund të aplikojnë edhe personat, të cilët nuk janë personel akademik pranë USH-së, por përmbushin standardet përfitimin e titujve.

4. Personeli akademik, që mban titullin "Profesor", pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij dhe me vendim të Senatit Akademik, i akordohet titulli "Profesor emeritus".

Neni 21

Procedurat përfitimin e titujve akademikë

1. Kandidati përfitimin e titullit "Profesor" ose "Profesor i asociar" paraqet dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore. Dosja e kandidatit i përcillet Senatit Akademik, pas paraqitjes dhe vlerësimit në njësinë bazë. Senati i kalon dosjen Komisionit të Pérhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, i cili merr vendimin përfundimtar pas vendimit të jurisë mbi përmbushjen e standardeve.

2. Titulli regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse përsëri. Titulli akademik lëshohet nga USH dhe firmoset nga rektori.

3. Në rast vlerësimi negativ të kërkesës përfitimin e titullit akademik nga Komisioni i Pérhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, kandidatit i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se dy vjet.

Neni 22

Fitimi i gradës shkencore "Doktor"

1. Në njësitë kryesore të USH-së krijohen komisionet e pérhershme që monitorojnë procesin përdhënien e gradës shkencore "Doktor".

2. Anëtarët e komisionit të përhershëm, për dhënien e gradës shkencore "Doktor", përzgjidhen nga personeli akademik i njësisë kryesore përkatëse. Ata mbajnë titullin "Profesor" ose "Profesor i asocuar". Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Numri minimal i anëtarëve të komisionit për dhënien e gradës shkencore "Doktor" duhet të jetë pesë vetë.
4. Mbledhja e parë komisionit për dhënien e gradës shkencore "Doktor" thirret dhe drejtohet nga Dekani i Fakultetit përkatës. Në mbledhjen e parë Komisioni zgjedh drejtues të tij një nga anëtarët që ka titullin "Profesor".

Neni 23

Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit

1. Në USH në rang universiteti dhe në njësitë kryesore krijohen komisionet për garantimin e standardeve të cilësisë dhe të programeve të studimit.

2. Këto komisione kanë këto detyra:

- a) sigurimin e cilësisë në USH dhe në njësitë kryesore, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë;
- b) monitorojnë dhe vlerësojnë cilësinë e USH-së ose të njësisë kryesore duke u bazuar mbi udhëzuesit e ASCAL-it dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë;
- c) vlerësojnë paraprakisht cilësinë e programeve të studimit që ofrojnë njësitë bazë dhe monitorojnë cilësinë e tyre;
- d) sigurojë ngritjen dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në USH dhe në njësitë kryesore;
- e) hartojnë dhe miratojnë procedurat, kriteret dhe formatet e vlerësimit të cilësisë akademike në USH dhe njësinë kryesore.

Neni 24

Sigurimi i brendshëm i cilësisë

1. Në USH krijohet njësia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë.

2. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë ka këto detyra:

- harton politika dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat miratohen në Senatin Akademik;
- vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore;
- në fund të semestrit, para sezonit të provimeve, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies përlendët e çdo programi studimi;
- realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë;
- harton dhe i propozon Senatit standarde përsigurimin e cilësisë në përpunhje me Kodin e Cilësisë;
- prezanton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së USH-së në Senatin Akademik, i cili miraton raportin vjetor përfundimtar të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në USH.

Neni 25

Komisioni që mbikëqyr mbarvajtjen e veprimtarisë së USH dhe marrëdhëniet me studentët.

1. Në rang universiteti krijohet Komisioni që mbikëqyr mbarëvajtjen e veprimtarisë së USH-së

dhe marrëdhëniet me studentët. Komisione të tilla krijohen dhe në njësitë kryesore.

2. Komisioni i USH-së ka këto detyra:

- a) të kërkojë informacion mbi veprimtarinë akademike nga të gjitha njësitë akademike të USH-së;
- b) të kërkojë informacion mbi veprimtarinë administrative nga njësitë e administrimit në USH;
- c) të përcaktojë mjetet dhe mënyrat e vendosjes së marrëdhënieve të USH-së me studentët;
- d) Komisioni kërkon raporte nga komisionet përkatëse të njësive kryesore dhe raporton në Rektorat dhe në Senatin Akademik të USH-së.
- e) të krijojë lidhje me shoqatat studentore.

3. Komisionet e njësive kryesore kanë detyrë:

- a) të kërkojnë informacion mbi veprimtarinë akademike nga njësitë bazë të fakultetit;
- b) të kërkojnë informacion mbi veprimtarinë administrative të njësive të administrimit të njësisë kryesore;
- c) të përcaktojë mjetet dhe mënyrat e vendosjes së marrëdhënieve të njësisë kryesore dhe njësive bazë me studentët.

Neni 26
Rektorati

1. Rektorati është organ kolegjal me funksione akademike dhe ekzekutive. Rektorati kryesohet nga Rektori.

2. Rektorati përbëhet nga:

- a) rektori;
- b) zëvendësrektori/ët;
- c) administratori i USH-së;
- d) drejtuesit e njësive kryesore /dekanët;

3. Rektorati i USH-së ushtron këto funksione:

- a) harton planin strategjik të zhvillimit të USH-së, mbështetur në propozimet e njësive kryesore dhe njësive bazë të USH-së, si dhe të administratorëve të USH-së dhe të njësisve kryesore;
- b) harton programin vjetor të veprimtarive dhe ndjek zbatimin e tij;
- c) përcakton përparësítë pér financime pér njësitë kryesore të USH-së;
- d) harton dhe i propozon Senatit Akademik planin buxhetor vjetor dhe afatmesëm të USH-së (projektbuxhetit të USH-së);
- e) harton planin e investimeve, kontratave dhe marrëveshjeve, që janë kompetencë e tij;
- f) paraqet rekomandime pér projekt – programet e studimit, e kërkimit shkencor dhe të projekt- ndryshimeve strukturore në USH;
- g) zbaton vendimet e miratuara nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit;
- h) monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të USH-së;
- i) përgatit marrëveshjet pör rregullat e financimit ndërmjet USH-së dhe MASR-it;
- j) harton strukturën e përgjithshme të USH-së, përcakton numrin e personelit në të gjitha nivelet dhe ia propozon Senatit akademik pér miratim;
- k) harton dhe miraton strukturën pér veprimtarinë mësimore në USH pér vitin akademik;
- l) përgatit rregulloren së tij të brendshme, e cila miratohet nga Senati Akademik.

m) ushtron kontolle në programet dhe planet mësimore të fakulteteve dhe departamenteve, në planet vjetore e mujore përkatëse në njësitë e USH-së dhe zbatimin e akteve të organeve të Universitetit;

a) ka të drejtë të shfuqizojë vendimet e dekanatit kur ato bien ndesh me aktet ligjore e mënligjore në suqi, me këtë Statut, me rregulloret e USH-së dhe me vendimet e Senatit.

b) i kerkon administratorit të USH-së të informojë për veprimtarinë financiare dhe administrative në USH, në çdo rast kur e sheh të nevojshme;

4. Rektorati, në fund të çdo viti akademik, harton raportin vjetor të mësimdhënies e kërkimit shkencor dhe ia paraqet atë për miratim Senatit Akademik.

5. Në ushtrimin e kompetencave të tij rektorati shprehet me vendime.

6. Mbledhjet e rektoratit thirren nga Rektori, kuorumi, shumicat për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e brendshme të Rektoratit.

Neni 27

Dekanati

1. Dekanati është organ kolegjal akademik dhe administrativ që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:

- a)** dekani;
- b)** zëvendësdekani/ët;
- c)** administratori i njësisë kryesore;
- d)** drejtuesit e njësive bazë;
- e)** drejtuesit e instituteve/qendrave kërkimore.

2. Funksionet akademike të dekanatit:

- a)** miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore, kërkimore e shkencore;
- b)** koordinon veprimtarinë e njësive bazë, miraton kërkesat e njësive bazë për programe të reja studimi dhe ia propozon Senatit Akademik për miratim;
- c)** miraton kërkesat e njësive bazë për hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh ose njësish të tjera dhe ia propozon Senatit Akademik për shqyrtim dhe miratim të mëtejshëm;
- d)** harton dhe miraton rregulloren e fakultetit.

3. Në ushtrimin e kompetencave të tij dekanati shprehet me vendime.

4. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të dekanatit, kuorumi, shumicat për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e brendshme të Dekanatit.

Neni 28

Bordi i Administrimit

1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë administrativ. Bordi i Administrimit është organ kolegjal i cili garanton përbushjen e misionit të USH-së, imbarëvajtjen financiare, administrative dhe të pronave të tij.

2. Funksionet e Bordit të Administrimit:

- a)** garanton qëndrueshmërinë financiare të USH-së dhe përbushjen e misionit të tij;
- b)** me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të USH-së dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- c)** me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe afatmesëm të USH-së dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- d)** me propozim të Senatit Akademik, miraton raportin për veprimtarinë financiare të USH-së

në gjysmën e vitit buxhetor (korrik) dhe në fund të vitit buxhetor (janar) me shumicën e të gjithë anëtarëve:

e) më propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;

f) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe përdorjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

g) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;

h) miraton rregulloren financiare të USH-së:

i) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron USH nga ushtrimi i veprimtarive të tij dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

j) cakton kriteret e procedurat për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e USH-së;

k) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve;

l) miraton paraprakisht Statutin e USH-së, para se t'i përcillet Senatit Akademik; me jo më pak se 3/5-at e votave të anëtarëve;

m) miraton raportin vjetor të veprimtarisë së USH-së, të hartuar nga rektorati;

n) vlerëson planin e zhvillimit të USH-së dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;

o) miraton rregulloren e brendshme për administrimin financier dhe kontabilitetin në USH;

p) miraton rregulloren e brendshme të tij;

q) miraton paraprakisht tarifën e regjistrimit në USH dhe ia përcjell për miratim Senatit Akademik:

r) i propozon MASR-it kriteret për përcaktimin e nivelit të pagave të punonjësve mësimorë dhe jomësimorë, si dhe tarifën e orës mësimore;

s) përcakton kriteret për përgjedhjen e Administratorit të USH-së.

3. Bordi i Administrimit përbëhet nga 7 anëtarë të punësuar me kohë të pjesshme. Përbërja e tij përcaktohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të USH-së, të miratuar nga Bordi i Administrimit.

a) Nëse USH siguron vetë pesëdhjetë për qind ose më shumë të buxhetit afatmesëm, katër prej anëtarëve janë përfaqësues të USH-së dhe tre janë përfaqësues të MASR-it.

b) Nëse USH siguron vetë më pak se pesëdhjetë për qind të buxhetit afatmesëm, tre prej anëtarëve janë përfaqësues të USH-së dhe katër janë përfaqësues të MASR-it.

c) Nëse Bashkia Shkodër kontribuon finansiarisht, së paku në masën dhjetë për qind të buxhetit afatmesëm të USH-së, atëherë një prej përfaqësuesve, që i takon MASR, përcaktohet nga kryetari i Bashkisë Shkodër.

4. Niveli i kontributit finansiar të MASR-it, të Bashkisë Shkodër dhe të USH-së bazohet në planin buxhetor afatmesëm të USH-së, me marrëveshje midis tyre. Ky plan përditësohet çdo vit. Në fund të vitit të tretë finansiar bëhet rivlerësimi i financimit dhe përcaktimi i pjesëmarrijes së kontribuesve në Bordin e Administrimit.

5. Anëtarët e Bordinit të Administrimit, përfaqësues të USH-së, zgjidhen nga Senati Akademik me të drejtë rizgjedhjeje. Kandidatët për anëtarë të Bordinit të Administrimit vetëkandidojnë ose propozohen nga njësítë bazë të USH-së. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësítë bazë të USH-së.

6. Bordi i Administrimit zgjedh kryetarin, me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë anëtarëve.

7. Rektori, drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë, dhe administratorët nuk mund

të jenë anëtarë të Bordit të Administrimit, por mund të stohen të marrin pjesë në mbledhjet e tij.

8. Mandati i anëtarit të Bordit të Administrimit është 5-vjeçar dhe është i papajtueshmë me atë të anëtarit të Senatit Akademik ose funksion tjetër në USH .

9. Mandati i anëtarit të Bordit të Administrimit mbaron kur:

a) pëmbushet afati i mandatit;

SH b) nuk dorëheqjen;

c) largohet nga USH, për ata që janë të caktuar nga Senati i USH-së;

d) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;

e) kur nuk merr pjesë, për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme, në mbledhjet e Bordit të Administrimit;

f) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

g) për shkelje të rënda të ligjit;

h) ndryshojnë raportet e përfaqësimit në organin drejtues;

i) kur shkarkohet nga organi që e ka zgjedhur / emëruar.

10. Shkarkimi i anëtarëve të Bordit të Administrimit bëhet nga Ministri i MASR-it, me propozimin e organit që i zgjedh apo emëron.

11. Në rast mbarimi të parakohshëm të mandatit të anëtarëve të zgjedhur në Bordin e Administrimit mandati i anëtarit të ri të zgjedhur/emëruar është plotësues.

12. Rektori dhe Administratori i USH-së kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit të Administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga Bordi i Administrimit.

13. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Bordit të Administrimit, kuromi, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e brendshme të Bordit të Administrimit të USH-së. Mbledhja e parë për konstituimin e Bordit të Administrimit thirret nga Rektori i USH-së dhe drejtohet nga anëtari i brendshëm i personelit akademik me moshën më të madhe.

14. Administratori i USH-së siguron infrastrukturën administrative për zhvillimin e mbledhjeve dhe ruajtjen e dokumentacionit të Bordit të Administrimit.

Neni 29 Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës i USH-së është organ kolegjial administrativ. Këshilli i Etikës i USH-së përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të zgjedhur nga Senati Akademik me votat e gjysmës të gjithë anëtarëve të Senatit plus një votë.

2. Këshilli i Etikës promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në procesin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor dhe me veprimtaritë e tjera të USH-së.

3. Anëtarët e Këshillit të Etikës të USH-së janë personel akademik i punësuar me kohë të plotë në USH (si rregull, me titullin apo gradën më të lartë) dhe i propozohen Senatit nga Rektori. Këshilli duhet të ketë në përbërjen e tij një jurist.

4. Në mbledhjen e parë të tij, Këshilli i Etikës i USH-së, zgjedh kryetarin dhe miraton rregulloren e etikës së USH-së.

5. Mënyra e pranimit dhe e shqyrtimit të ankesave, vendimet, sanksionet përkatëse dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve, parashikohen në rregulloren e etikës të USH-së.

6. Këshilli i Etikës mund të ngrihet edhe në njësitë kryesore të USH-së/fakulteteve.



KREU IV

AUTORITETET DREJTUESE

Neni 30
Autoritetet drejtuese të USH-së

1. Autoritete drejtuese të USH-së janë:

- a) rektori;
- b) administratori i USH-së;
- c) drejtuesit e njësive kryesore (dekanët);
- d) administratoret e njësive kryesore
- e) drejtuesit e njësive bazë (Drejtorët e departamenteve)
- f) administratori i njësisë bazë

Neni 31
Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i USH-së dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.

2. Rektori zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përgjedhjen e rektorit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidatët për rektor vetëkandidohen. Rektori dekretohet nga Presidenti i Republikës

3. Rektori në USH mban titullin "Profesor" dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij.

4. Mandati i rektorit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

5. Rektori drejton Senatin Akademik dhe raporton para tij.

6. Rektori është përfaqësuesi i USH-së në Konferencën e Rektorëve.

7. Rektori ka këto detyra dhe kompetenca

- a) i paraqet senatin planin strategjik të zhvillimit të USH-së;
- b) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e të gjitha strukturave të USH-së. Siguron unitetin e USH-së dhe është garant i autonomisë universitare brenda USH-së.
- c) përfaqëson USH-në në marrëdhënie me të tretët,
- d) ka të drejtë të shfuqizojë vendimet e dekanit kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me këtë Statut, me rregulloret e USH-së dhe me vendimet e Senatit.
- e) garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të Statutit dhe të rregulloreve të brendshme të USH-së;
- f) nënshkruan në emër të USH-së marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të tjera homologe, nënshkruan protokollin e anëtarësimit të USH-së në shoqata e organizata kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë ose të tjera, nënshkruan dokumentacionin e bashkëpunimit me organizata joqeveritare e donatorë vendas apo të huaj që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit

të lartë:

g) cakton delegacionet dhe miraton planet e kualifikimit dhe të specializimit jashtë shtetit të mësinjshënësve, kërkuesve dhe të personelit administrativ;

h) siguron mbarëvajtjen e proceseve të konkurrimit për pranimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik dhe i miraton ato;

i) rektori nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik në

USH-së

j) nënshkruan diplomat e përfundimit të studimeve në cikle të ndryshme;

k) emëron kryetarët e degëve, specialistët e lartë dhe personelin tjetër në USH në vartësi të tij;

l) miraton personelin mësimor e shkencor, i cili, për vitin akademik, do të ketë ngarkesë më të ulët nga norma mësimore, duke përcaktuar këtë ngarkesë;

m) miraton modelin e kontratës që nënshkruan me personelin akademik;

n) miraton planin kalendarik të procesit mësimor për çdo vit akademik në bazë të udhëzimeve të MASR-it;

8. Rektori ka për detyrë të denoncojë rastet e cënimit të paprekshmërisë së USH-së, sipas dispozitive ligjore në suqi:

9. Rektori i propozon Ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë kryesore, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së USH-së dhe brenda dy muajve nga data e shkarkimit cakton njërin prej zëvendësve të autoritetit deri në zgjedhjen e autoritetit të ri. Rektori, menjëherë pas shkarkimit, shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit;

10. Rektori ushtron të drejtën e marrjes së masave administrative dhe disciplinore ndaj personelit në vartësi të tij deri në lirimin nga detyra duke u bazuar në rregulloret dhe aktet ligjore e nënligjore dhe ndaj studentëve, deri në përjashtimin nga shkolla;

11. Funksioni i Rektorit është i papajtueshëm me funksionet e përgjegjësve të strukturave të USH-së, si dhe të kryetarit të komisionit të diplomës dhe të provimit të formimit;

12. Rektori emëron dhe shkarkon zëvendësrektorin/ët, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Senatin Akademik;

13. Në mungesë, Rektori i delegon kompetenca zëvendësit/ve të tij;

14. Rektori në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhra dhe udhëzime.

Neni 32 Drejtuesi i njësisë kryesore / Dekani.

1. Dekani është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.

2. Dekani zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore dhe studentët e njësisë kryesore përkatëse. Votat e studentëve në zgjedhjen e drejtuesit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave.

3. Rektori emëron drejtues të njësisë kryesore kandidatin fitues të zgjedhjeve.

4. Kandidati për drejtues të njësisë kryesore vetëkandidohet. Ai është personel akademik i kategorisë "Profesor" dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij. Kandidati për dekan duhet të ketë së paku 10 vite punë në arsimin e lartë.

5. Mandati i drejtuesit të njësisë kryesore zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedheje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

6. Dekani ka këto detyra dhe kompetenca :

- a) dekani i përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
- b) paraqet në rektorat dhe në Senatin Akademik të USH-së propozime për probleme të ndryshme të dekanatit;
- c) informon dekanatin për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fakultet;
- d) miraton planin kalendarik të procesit mësimor për çdo vit akademik në bazë të udhëzimeve të rektoratit dhe të strukturës mësimore vjetore;
- e) ndjek plotësimin korrekt të dokumentacionit shkollor;
- f) i propozon dekanatit me kërkesë te departamentit hapjen, mbylljen, reformimin e programeve të studimit, të departamenteve apo të njësive të veçanta në fakultet;
- g) i propozon dekanatit hapjen e qendrave kërkimore dhe të zhvillimit, të programeve të ndryshme të studimeve, ofrimin e shërbimeve të ndryshme për të tretët, pjesëmarjen në projekte brenda apo jashtë vendit;
- h) organizon dhe mbikëqyr cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, të zbatimit të kontratave të punës dhe të çdo detyrimi tjetër të marrë përsipër nga departamentet apo personeli i fakultetit;
- i) ka të drejtë të shfuqizojë vendimet e përgjegjësit të departamentit kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në suqi, me këtë Statut, me rregulloret e USH-së dhe me vendimet e Senatit e të dekanatit;
- j) me autorizimin e Rektorit ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me fakultete e institucione homologe të vendit e të huaja;
- k) emëron përgjegjësit e zgjedhur të departamenteve;
- l) drejton dhe kontrollon konkurset e pranimit të punonjësve akademikë e joakademikë në fakultetin e tij;
- m) propozon masa administrative dhe disiplinore, sipas rregulloreve të miratuara dhe të akteve ligjore e nënligjore ndaj personelit deri në lirimin nga detyra ndërsa ndaj studentëve deri në përjashtimin nga shkolla.

7. Mandati i Dekanit mbaron kur:

- a) përfundon afati i mandatit;
- b) jep dorëheqjen;
- c) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
- d) kur shkarkohet nga detyra;
- e) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

8. Rektori i propozon Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë kryesore të institucionit publik, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së USH-së. Ministri shprehet brenda një muaji. Rektori cakton njërin prej zëvendësve të autoritetit deri në zgjedhjen e autoritetit të ri brenda dy muajve nga data e shkarkimit. Rektori, menjëherë pas shkarkimit, shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.

9. Drejtuesi i njësisë kryesore i propozon rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë bazë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë përkryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së USH-së. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i drejtuesit të njësisë bazë caktohet nga rektori, me propozimin e drejtuesit të njësisë kryesore. Rektori shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.

10. Drejtuesi i njësisë kryesore i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësisë kryesore.

11. Dekani në ushtrimin e kompetencave të tij, shprehet me urdhëra dhe udhëzime.

Neni 33 **Drejtuesi i njësisë bazë**

1. Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë.

2. Drejtuesi i njësisë bazë zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë.

3. Drejtuesi i njësisë kryesore emëron drejtues të njësisë bazë kandidatin fitues të zgjedhjeve.

4. Kandidati për drejtues vetëkandidohet dhe është personel akademik i kategorisë "Profesor" ose ka gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universitetev të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore "Doktor". Kandidati për drejtues i njësisë bazë duhet të ketë së paku 5 vjet vjetërsi pune në arsimin e lartë.

5. Drejtuesi i njësisë bazë, mund të shërbejë në detyrë për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

6. Drejtuesi i njësisë bazë ka këto detyra dhe kompetenca:

a) harton planin vjetor dhe planet mujore të veprimtarisë së departamentit të cilat miratohen nga dekani;

b) është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në njësinë bazë;

c) përgjigjet për dokumentacionin e veprimtarisë akademike dhe shkencore në njësinë bazë;

d) kontrollon hartimin e planeve dhe programeve mësimore të lëndëve që mbulon njësia bazë dhe ndjek zbatimin e tyre;

e) përgatit projektin për shpërndarjen e ngarkesës mësimore për anëtarët e departamentit. Projekt-ngaresha hyn në fuqi, pasi shqyrtohet dhe miratohet nga njësia bazë;

f) cakton komisionet e provimeve të lëndëve;

g) ushtron kontrolle për cilësinë e mësimdhënies;

h) cakton anëtarët në komisionet për pranimin e punonjësve akademikë në njësinë bazë dhe është kryetar i këtyre komisioneve.

i) i propozon dekanit masa administrative dhe disiplinore ndaj personelit të njësisë bazë deri në lirimin nga detyra dhe masa disiplinore ndaj studentëve deri në përashtimin nga shkolla, bazuar në rregulloret dhe në aktet ligjore e nënligjore.

7. Përgjegjësi i Qendrës së kërkimit-shkencor ka këto detyra dhe kompetenca:

a) harton planin vjetor dhe planet mujore të veprimtarisë së qendrës të cilat miratohen nga Dekani;

b) ndjek zbatimin e planeve kërkimore-shkencore;

c) përcakton komisionet për pranimin e punonjësve akademikë në Qendrën e kërkimit shkencor dhe është kryetar i tyre;

d) është personi përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të kërkimit-shkencor në Qendër;

8. Mandati i drejtuesit të njësisë bazë mbaron kur:

a) përfundon afati i mandatit;

b) jep dorëheqjen;

ODE b) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;

d) kur shkarkohet;

e) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

9. Drejtuesi i njësisë bazë në ushtrim të kompetencave të tij, shprechet me urdhra dhe udhëzime.

10. Drejtuesi i njësisë bazë i propozon administratorit të USH-së shkarkimin e administratorit të njësisë bazë.

Neni 34 Zëvendësrektori

1. USH ka një zëvendësrektor. Ndryshimi i numrit dhe kompetencave të tyre bëhet me vendim të SA.

2. Zëvendësrektori/ët është autoritet që ushtron veprimtari drejtuese në USH.

3. Zëvendësrektori/ët emërohet dhe shkarkohet nga Rektori i USH-së, pas miratimit me mbi 50 % të votave të gjithë anëtarëve të Senatit Akademik të kandidaturës së propozuar.

4. Zëvendësrektori/ët duhet të jetë anëtar/ë i/të personelit akademik me kohë të plotë në USH dhe duhet t'i pëkasë kategorisë "Profesor" ose të ketë gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të UECD-së ose të BEe dhe me një përvojë dhjetëvjeçarc akademike në universitete.

5. Zëvendësrektori/ët, në mungesë të rektorit, siguron drejtimin e punëve në USH, sipas përcaktimeve të këtij Statuti apo detyrave të lëma nga Rektori.

6. Zëvendësrektori/ët, në mungesë të rektorit dhe me porosi të tij, nënshkruan aktet përkatëse.

7. Zëvendësrektori/ët ka këto detyra dhe kompetenca:

a) harton planin kalendarik të procesit mësimor sipas udhëzimit të ministrisë përkatëse;

b) ndjek punën mësimore, punën shkencore në USH dhe ngarkesën e personelit mësimor-shkencor të tij;

c) ndjek hartimin dhe zbatimin e planeve dhe të programeve mësimore në njësitë bazë (fakultetet) për të gjitha ciklet e studimit;

d) organizon e ndjek punën e kualifikimit e të specalizimit pasuniversitar, të shkollave e të kurseve pasuniversitare dhe procesin e doktoraturave;

e) drejton e kontrollon punën për pranimin e studentëve të rinj në USH.

8. Ka në varësi dhe kontrollon veprimit të Drejtorisë së Kurrikulave, kërkimit Shkencor dhe Standardeve.

9. Funksioni i zv/rektorit është i papajtueshëm me funksionet e përgjegjësit të strukturave të USH-së.

10. Zëvendësrektori/ët largohet nga detyra kur:

a) përfundon mandatin;

b) jep dorëheqjen;

- c) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
- d) shkarkohet nga Rektori sipas pikës 2 të këtij neni;
- e) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Neni 35

Zëvendësdekani/ët

1. Zëvendësdekani/ët është autoritet që ushtron veprimitari drejtuese në njësinë kyesore.

JEP 2. Zëvendësdekani/ët emërohet dhe shkarkohet nga Dekani.

3. Zëvendësdekani/ët duhet të ketë të paktën gradën shkencore "Doktor" dhe me një përvojë akademike në universitet të paktën 5 (pesë) vjet.
4. Zëvendësdekani/ët, në mungesë të dekanit, siguron drejtimin e punëve në njësinë kryesore, sipas përcaktimeve të këtij Statuti apo detyrave të lëna nga Dekani.
5. Zëvendësdekani/ët ka këto detyra dhe kompetenca:

- a) detajon planin kalendarik të procesit mësimor pas propozimeve nga drejtuesit e njësive bazë të fakultetit;
- b) ndjek punën mësimore, punën shkencore në njësinë kryesore dhe ngarkesën e personelit mësimor-shkencor të tij;
- c) ndjek hartimin e zbatimin e planeve dhe të programeve mësimore në njësitë bazë (departament) për të gjitha ciklet e studimit;
- d) drejton e kontrollon punën për pranimin e studentëve të rinj në njësinë kryesore;
- e) ndjek vlerësimin e brendshëm të cilësisë dhe organizon vlerësimin e brendshëm të njësive bazë të fakultetit dhe procesin e akreditimit.

6. Funksioni i zv/dekanit është i papajtueshëm me funksionet e përgjegjësit të departamentit dhe të strukturave të njësise kryesore.

7. Zëvendësdekani/ët largohet nga detyra kur:

- a) përfundon mandatin;
- b) jep dorëheqjen;
- c) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
- d) shkarkohet nga detyra;
- e) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale

Neni 36

Administratori i USH-së.

1. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i USH-së për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.
2. Administratori i USH-së zgjidhet me konkurs të hapur publik. Kriteret për përzgjedhjen e Administratorit të USH-së përcaktohen nga Bordi i Administrimit.
3. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret për administrator në USH miratohet nga Senati Akademik. Nga lista e miratuar nga Senati Akademik me 2/3 (dy të tretat) e votave të gjithë anëtarëve të tij. Bordi i Administrimit zgjedh Administratorin e USH-së. Emri i administratorit të zgjedhur shpallet në faqen zyrtare online të USH-së.
4. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit me vendim të nënshkruar nga Kryetari i Bordit të Administrimit të USH-së.

5. Administratori i USH-së shkarkohet me vendim nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të tij, me nismën e vet ose me propozim të SA-së. Vendimi i shkarkimit të Administratorit të USH-së nëshkruhet nga Kryetari i Bordit.

6. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i shkencave", në fushën e drejtësisë, së paku shtatë vjet në këto fusha.

7. Administratori nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjeter, akademik apo administrativ.

8. Administratori i raporton për veprimtarinë e tij Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik në përfundim të gjashtëmujorit të parë të vitit buxhetor (korrik) dhe në përfundim të vitit buxhetor (janar), si dhe në çdo rast kur këto organe e shohin të nevojshme.

9. Funksionet e Administratorit të USH-së:

a) harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm;

b) i paraqet Senatit projektin për detajimin e fondeve buxhetore, si dhe të burimeve të tjera të financimit;

c) është përgjegjës për zbatimin e buxhetit;

d) propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre

e) ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të USH-së në strukturat e varësisë së tij;

f) zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;

g) përgatit projekt raportin mbi veprimtarinë financiare të USH-së, i cili miratohet nga rektorati i USH-së me shumicën e gjithë anëtarëve;

h) paraqet raportin mbi veprimtarinë financiare të USH -së në Bordin e Administrimit dhe Senatin Akademik në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit buxhetor (korrik) dhe në fund të vitit buxhetor (janar) ;

i) bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të USH-së për çështje të administrimit të përditshëm;

j) emëron dhe shkarkon administratorët e njësive kryesore dhe njësive bazë pas miratimit të Bordit të Administrimit;

k) plotëson kërkesat e rektorit, me qëllim përbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;

l) drejton veprimtarinë e personelit administrativ në vartësi të tij;

m) realizon administrimin financier;

n) drejton planifikimin dhe realizimin e investimeve;

o) me autorizimin e rektorit, përfaqëson ose bashkëpërfaqëson USH-në në të gjitha proceset gjyqësore apo zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me palët e treta, persona fizikë ose juridikë.

p) është përgjegjës për zbatimin e ligjshmërisë;

q) organizon dhe menaxhon procesin zgjedhor në USH dhe përgjigjet për mbarëvajtjen e tij;

r) organizon veprimtarinë e shërbimeve ndaj të tretëve në USH;

s) paraqet aktet ekonomike dhe financiare për miratim në Bordin e Administrimit dhe përmendim paraprak në Senatin akademik.

10. Administratori largohet nga detyra kur:

a) përfundon mandatin;

b) jep dorëheqjen;

c) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;

d) shihet sipas pikës 5 të këtij neni.

Neni 37

Administratori i njësisë kryesore

1. Administratori i njësisë kryesore është përgjegjës për mirëfunkcionimin financiar dhe administrativ të saj.

2. Administratori i njësisë kryesore zgjidhet me konkurs të hapur publik, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit.

3. Administratori i njësisë kryesore duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune, së paku pesë vjet në këto fusha.

4. Administratori i njësisë kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.

5. Administratori i njësisë kryesore i raporton për veprimtarinë e tij administratorit të USH-së, si dhe informon drejtuesin e njësisë kryesore, sipas përcaktiveve në aktet e USH-së.

6. Administratori i njësisë kryesore propozon shkarkimin e administratorëve të njësive bazë.

7. Funksionet e Administratorit të njësisë kryesore:

a) realizon administrimin e përditshëm financiar të njësisë kryesore;

b) mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të njësisë kryesore;

c) plotëson kërkesat e drejtuesit të njësisë kryesore, me qëllim përbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;

d) bashkëpunon me autoritetet dhe organet drejtuese të njësisë kryesore për çështjet themelore të administrimit të saj.

Neni 38

Administratori i njësisë bazë

1. Administratori i njësisë bazë është përgjegjës për mirëfunkcionimin financiar të saj. Ai ushtron veprimtarit mbështetëse në funksion të realizimit të misionit të një ose më shumë njësive bazë. Bordi i Administrimit, me kërkesë të njësisë bazë, propozon përfshirjen ose jo të këtij autoriteti në strukturën e institucionit.

2. Ai zgjidhet nga administratori i institucionit, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit.

3. Administratori i njësisë bazë duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin "Master i shkencave", në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku tre vjet në këto fusha.

4. Administratori i njësisë bazë nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.

5. Administratori i njësisë bazë i raporton për veprimtarinë e tij administratorit të njësisë kryesore dhe drejtuesit të njësisë bazë, sipas përcaktiveve në aktet e institucionit të arsimit të lartë.

6. Funksionet e administratorit të njësisë bazë janë:

a) administron fondet e njësisë/njësive bazë;

b) zbaton vendimet e administratorit të njësisë kryesore për mënyrën e ndarjes së të ardhurave të krijuara nga njësia/njësitë bazë;

c) plotëson kërkesat e drejtuesit të njësisë bazë, me qëllim përbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.



KREU V PERSONELI I UNIVERSITETIT

Neni 39 Struktura e përgjithshme dhe organika

1. Rektorati i propozon Senatit Akademik strukturën e personelit dhe numrin e tyre për çdo njësi.
2. Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet.
3. Personeli i USH-së ndahet në këto kategori: personel akademik, personel ndihmës akademik dhe personel administrativ.
4. Personeli i USH-së punësohet me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar dhe me kohëzgjatje të caktuar.

Neni 40 Personeli akademik

1. Personeli akademik në USH, sipas rolit dhe veprimitarise që kryen, kategorizohet në:
 - a) profesorë;
 - b) lektorë;
 - c) asistent-lektorë.
2. Personeli akademik në USH punësohet me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.
3. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përfshin:
 - a) personelin akademik me kohë të plotë me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
 - b) personelin akademik me kohë të plotë me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.
4. Personeli akademik me kohë të pjesshme punësohet vetëm me kontratë me kohëzgjatje të caktuar një semestër ose deri në një vit.
5. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.

Neni 41 Personeli akademik me kohë të plotë me kohëzgjatje të pacaktuar

1. Personeli akademik me kohë të plotë me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar përfshin personelin e kategorisë "Profesor" dhe të kategorisë "Lektor".
2. Kategoria "Profesor" përfshin anëtarët e personelit akademik me titull akademik "Profesor," dhe "Profesor i asociar," të cilët janë titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimitarisë së kërkimit shkencor.
3. Personeli akademik që mban titullin "Profesor", shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç. Kjo kategori e personelit akademik, pasi mbush moshën për pension, mund të punësohet pa konkurs publik, me kontratë me kohëzgjatje të caktuar vetëm për një vit, me të drejtë rinovimi edhe një vit, nëse vendi mbetet vakant.

4. Personeli akademik që mban titullin “Profesor i asociuar”, shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç.

5. Personeli akademik i kategorisë “Profesor” mund të shkëputet përkohësisht nga USH për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, për t'u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike, me të drejtën e rikthimit pa konkurs publik në vendin e mëparshëm të punës. Gjatë periudhës së shkëputjes zëvendësohet nga personeli akademik i punësuar me kontratë me afat të caktuar.

R6. Kategoria “Lektor” përfshin anëtarët e personelit akademik me gradën shkencore “Doktor” që kanë së paku 3 vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade dhe që zhvillojnë veprimitari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Kjo kategori punësohet me kohë të plotë me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.

7. Personeli akademik i kategorisë “Profesor,, dhe “Lektor,, me miratim të njësisë bazë ka të drejtën e vitit akademik sabatik, që çdo 7 vjet deri në një vit të punojë për përparrimin e tij akademik. Gjatë këtij viti nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje dhe i lejohet të ndjekë edhe kurse specializimi deri tremujore jashtë institucionit. Rektori i USH-së miraton përfundimisht ushtrimin e kësaj të drejte dhe nënshkruan kontratën e posaçme me personelin që e përfiton atë.

Neni 42

Personeli akademik me kohë të plotë me kohëzgjatje të caktuar.

1. Personeli akademik me kohë të plotë me kontratë me kohëzgjatje të caktuar përfshin personelin e kategorisë “Asistent-lektorë”.

2. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën “Master i Shkencave,, dhe të përbushin kriteret e përcaktuara “Rregulloren e zënies dhe ruajtjes së vendit të Punës” të USH-së dhe kriteret e posaçme të përcaktuara nga departamenti përkatës.

3. Asistent-lektorit që brenda pesë vjetëve nuk ka fituar gradën shkencore “Doktor” në fushën ku zhvillon veprimitarinë mësimore- kërkimore nuk i rinovohet kontrata.

Neni 43

Punësimi i personelit akademik

1. Punësimi i personelit akademik në USH bëhet vetëm me konkurs të hapur publik. Kriteret dhe procedurat e përgjithëshme të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen në rregulloren e USH-së “Për zënen e ruajtjen e vendit të punës në USH”.

2. Kriteret specifike të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga rektori.

3. Konkursi i punësimit të personelit akademik në USH drejtohet nga një komision ad-hoc, i përbërë nga tre përfaqësues të njësisë bazë, një përfaqësues i njësisë kryesore dhe një përfaqësues i rektoratit. Kryetar i komisionit ad-hoc është përgjegjësi i departamentit.

4. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në USH nuk mund të punësohet si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjeter të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Ai mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjeter të arsimit të lartë, me miratimin e drejtuesit të njësisë bazë dhe të rektorit, si dhe në marrëveshje mes institacioneve.

5. Pjesëmarrja e personelit akademik të USH-së në projekte, konsulenca, botime dhe shërbime”, që realizohen në USH, ku ai është i punësuar me kohë të plotë, nuk konsiderohet si dypunësim brenda institucionit.

Neni 44 **Personeli akademik i ftuar**

1. Në kategorinë personel akademik i ftuar përfshihen studiues, personalitete, artistë vendas ose të huaj, të cilët punësohen në USH pa konkurs publik, për një semestër ose për një vit akademik. Kontrata e personelit akademik të ftuar nuk përsëritet.
2. Kriteret për përzgjedhjen e personelit akademik të ftuar përcaktohen në rregulloren e njësisë kryesore. Njësia bazë i propozon dekanit emrat dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik të ftuar dhe dekani ia propozon Rektorit.
3. Rektori merr vendimin për punësimin e personelit akademik të ftuar dhe nënshkruan kontratën e punës.

Neni 45 **Personelit akademik me kohë të pjesshme**

1. Në këtë kategori përfshihet personeli akademik që punësohet për mësimdhënie e kërkim shkencor si personel akademik i jashtëm me ngarkesë mësimore deri në 150 orë.
2. Punësimi i personelit akademik me kohë të pjesshme në USH bëhet me konkurs të hapur publik, me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për një semestër ose deri në një vit akademik.
3. Kriteret dhe procedurat e përgjithshme të punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme përcaktohen në rregulloren përkatëse të USH-së "Për zëniën e ruajtjen e vendit të punës në USH".
4. Kriteret specifike të punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga rektori.

Neni 46 **Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik.**

1. Të drejtat e personelit akademik:
 - a) të zhvillojë mësimdhënie dhe kërkim shkencor në respektim të lirisë akademike;
 - b) të mos pengohet gjatë ushtrimit të veprimtarivë akademike dhe shkencore;
 - c) të paguhet sipas kualifikimit shkencor dhe për orët shtesë në masën e lejuar nga dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi;
 - d) të përfitojë lejen vjetore të paguar;
 - e) të kryejë kualifikime shkencore, brenda apo jashtë vendit;
 - f) të kryejë detyra të tjera jashtë funksionit bazë, pa konflikt interesit me USH-në .
2. USH mund të kontribuojë në trajtimin e veçantë financiar të personelit akademik, krahas përfitimeve nga Buxheti i Shtetit.
3. Bordi i Administrimit i USH-së me propozim të SA-së përcakton rastet dhe kriteret e trajtimit të veçantë financiar dhe përfitimeve të tjera të personelit akademik.
4. Detyrimet e personelit akademik:
 - a) të zbatojë legjislacionin për arsimin e lartë gjatë ushtrimit të detyrës dhe të respektojë rregullat e Kodit të Etikës së USH-së;
 - b) të kryejë veprimitari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor bazë ose të aplikuar,
 - c) të kryejë shërbime për zhvillimin e USH-së dhe të kryejë detyra administrative sipas nevojave të departamentit, fakultetit apo universitetit;
 - d) të zhvillojë konsultime apo këshillime më studentët;
 - e) të përmbushë detyrën e ngarkuar: ngarkesën mësimore, kërkimin shkencor dhe veprimitari

të tjera, sipas përcaktimeve në kontratën e punës dhe marrëveshjen vjetore të punës.

Neni 47
Personeli ndihmës akademik

1. Personeli ndihmës akademik përfshin dy kategori:
 - a) Personelin ndihmës akademik me karakter mësimor
 - b) personelin ndihmës akademik me karakter administrativ
2. Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë. Në këtë kategori futen laborantët dhe teknikët.
3. Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucional të konsiderohen:
 - a) Strukturat e kurrikulave
 - b) Strukturat e kërkimit shkencor
 - c) Strukturat e projekteve
 - d) Strukturat e promovimit akademik dhe të botimeve
 - e) Strukturat e marrëdhënieve me publikun
 - f) Strukturat e marrëdhënieve me jashtë
 - g) Strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë
 - h) Strukturat e karrierës
 - i) Strukturat e bibliotekave
 - j) Strukturat juridike
 - k) Strukturat e teknologjisë së informacionit
 - l) Strukturat e burimeve njerëzore
 - m) Strukturat e arkiv-protokollit
 - n) Asistent i Rektorit
4. Kriteret e punësimit të personelit ndihmës akademik përcaktohen në “Rregulloren e zënieve dhe ruajtjes së vendit të punës në USH”. Kriteret e punësimit të personelit ndihmës-akademik propozohen nga njësia përkatëse të cilës ky personel i shërben dhe miratohen nga rektori.
5. Pozita juridike, të drejtat dhe detyrimet e personelit ndihmës akademik përcaktohet në rregulloren e mësipërme dhe në kontratën individuale të punës.
6. Kandidatët fitues nënshkruajnë kontratën e punës me Rektorin, mbështetur në legjislacionin për Arsimin e Lartë dhe Kodin e Punës të RSH-së.
7. Kontrata e punës së personelit ndihmës akademik përfundon kur:
 - a) jep dorëheqjen ose largohet me dëshirën e tij;
 - b) mbush moshën e pensionit të pleqërisë;
 - c) bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar detyrën;
 - d) merr masën disiplinore të largimit nga detyra.
 - e) dënohet nga një vendim gjyqësor i formës së prerë.

Neni 48
Personeli administrativ

1. Struktura administrative në nivel institucional të konsiderohen:
 - a) Strukturat ekonomike
 - b) Strukturat e investimeve

- c) Strukturat e prokurimeve
 - d) Strukturat e shërbimeve
2. Me propozim të rektoratit SA harton strukturën e përgjithshme të USH-së dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet.
3. Procedurat e vlerësimit të punës së personelit administrativ, politikat e motivimit, shpërblimit, zhvillimit e trajnimit të tij, përcaktohen në rregulloren e posaçme të administratës së USH-së.
4. Punësimi i personelit administrativ bëhet me konkurs. Kriteret e punësimit hartohen nga drejtoria/dega përkatëse e administratori dhe miratohen nga Bordi i Administrimit. Procedurat e konkursit përcaktohen në "Rregulloren e zëties dhe ruajtjes së vendit të punës" të USH-së.

Neni 49 **Masat disiplinore**

1. Masat disiplinore për personelin akademik, ndihmës akademik dhe për personelin administrativ dhe organi që i jep ato, përcaktohen në rregulloret përkatëse të USH-së.
2. Masa disiplinore për personelin akademik propozohet nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe drejtuesi i njësisë bazë, ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë akademike.
3. Masa disiplinore për shkeljet nga personeli administrativ merret nga administratori me propozim nga drejtuesi i njësisë administrative.
4. Largimi nga detyra i personelit akademik bëhet nga rektori me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë, ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë e tij dhe pas miratimit të dhënë nga Këshilli i Etikës dhe komisioni ad-hoc, i ngritur nga Senati Akademik në rastin e shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të ligjit. Personeli akademik në rast të largimit nga detyra ka të drejtë të dëgjohet nga Senati Akademik.
5. Largimi nga detyra i personelit administrativ bëhet nga Administratori i USH-së.

KREU VI **ORGANIZIMI I STUDIMEVE**

Neni 50 **Format e studimeve në USH**

1. Format e studimeve në USH janë:
 - a) studime me kohë të plotë;
 - b) studime me kohë të zgjatur.
2. Programet e studimit që japid të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë.
3. USH afron programe studimi të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite në përpunthje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS).
4. Për një vit akademik programi i studimit duhet të përbajë 60 kredite.
5. Programet e studimeve hartohen nga njësitet bazë të institucioneve të arsimit të lartë dhe miratohen në senatet e tyre akademike.

Neni 51 **Ciklet e studimeve në USH**

1. Programet e studimeve në USH organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme:

a) cikli i parë;

b) cikli i dytë;

c) cikli i tretë

2. USH shpall publikisht programet e hapura dhe ato të akredituara të studimeve, para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve.

Neni 52

Cikli i parë i studimeve

1. Programet e ciklit të parë të studimit, organizohen me jo më pak se 180 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

2. Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Senati i USH-së përeakton në rregulloren e studimit të programit Bachelor pragu e notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të ciklit të parë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome.

3. Në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer.

Neni 53

Pranimet në ciklin e parë të studimit

1. Pranimet e studentëve në USH në të gjitha programet e studimit bëhen sipas kriterieve dhe kuotave të përcaktuara nga Senati Akademik. Kuotat e pranimeve përcaktohen në përputhje me standarde shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukturore, të cilat verifikohen dhe certifikohen nga ministria përpara deklarimit të kuotave të pranimit.

2. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Në fillim të vitit akademik, USH dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar.

Neni 54

Cikli i dytë i studimit

1. Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit, të referuara nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit:

A) "Master i shkencave";

B) "Master i arteve";

C) "Master profesional".

A1. Programet e studimit "Master i shkencave" pajisin të diplomuarit me njojuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar.

A2. Programet e studimit "Master i shkencave" organizohen në:

a) programe me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike;

b) programe të integruese të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 kredite dhë me kohëzgjatje normale respektivisht pesë vite akademike.

A3. Studimet e ciklit të dytë "Master i shkencave" përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i shkencave" në fushën e arsimimit të kryer.

B1. Programet e studimit "Master i arteve" pajisin të diplomuarit me njojuri të thelluara teorike

dhe praktike, në fushën e arteve.

B2. Këto programe realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike.

C1. Programet e studimeve “Master profesional” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar.

C2. Këto programe organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike.

C3. Studimet e ciklit të dytë “Master profesional” përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome. Senati i USH-së përcakton në rregulloren e studimit të programit pragun e notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të ciklit të dytë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimimit të kryer.

Neni 55

Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve

1. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga Senati i USH-së.

2. Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit.

3. Pranimi në programet e integruar të studimeve është i mundur për kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin nenin 74 pika 1 të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”. Kriteret e pranimit në programet e integruar të studimeve miratohen me vendim të Senatit të USH-së dhe bëhen publike nga njësia kryesore dhe QSHA.

4. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit European: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individu ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj sipas përcaktimit të aktin nënligjor të MASR.

5. Departamentet mund të njohin kredite të përsituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit “Master i shkencave”.

6. Në fillim të vitit akademik USH dërgon në QSHA listën e studentëve të regjistruar në ciklin e dytë të studimeve Master.

Neni 56

Programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Cikli i tretë i studimeve në USH përfshin studimet e doktoratës.

2. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për astësimin e pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese.

3. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”.

Neni 57

Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën "Master i shkencave" ose "Master i arteve" dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga USH në rregulloren përkatëse.
2. Kriteret e pranimit në programet e ciklit të tretë propozohen nga njësia që organizon doktoraturën në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe miratohen në Senatin e USH-së. Këto kriterë bëhen publike nga USH dhe i përcillen QSHA dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.
3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të tretë është njojja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njoitura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
4. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë përcillet nga USH në ministrinë përgjegjëse për t'u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë.

Neni 58 Studimet e doktoratës

1. Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë që organizon doktoraturën ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjeter të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
2. Kur studimet e doktoratës zhvillohen në bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor, mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese.
3. Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia që organizon doktoraturën dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore të kësaj të fundit.
4. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, studenti mund të përsitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo të vetëfinancohet.
5. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin "Profesor" ose "Profesor i asocuar". Numri i doktorantëve që mund të udhëheqin përcaktohet nga aktet nënligjore në fuqi dhe rregullorja e doktoraturës.

Neni 59 Programet e përbashkëta të studimit

1. USH ka të drejtën të organizojë programe të përbashkëta studimi me një institucion të arsimit të lartë ose njësi kryesore të tij, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit.
2. Realizimi i programeve të përbashkëta të studimit mund të kryhet në një ose në të dy institucionet pjesëmarrëse, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit.
3. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse.
4. Në kushtet e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore.
5. Hapja e programeve të përbashkëta të studimit bëhet me miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 60
Programet e studimit në fushën e mësuesisë

1. Programet e studimit në fushën e mësuesisë për arsim parashkollar dhe arsim fillor, organizohen në dy cikle:
- a. program i ciklit të parë, "Bachelor", që formon mësues të arsimit parashkollar;
 - b. program i ciklit të dytë "Master profesional", që formon mësues të arsimit fillor.
2. Programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesém të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", me 120 kredite, sipas fushave përkatëse të formimit.
3. Programet e ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë duhet të përbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik.
4. Programet e ciklit të dytë të studimit, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përbajtje të ngjashme.

Neni 61
Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Individët, që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përashtohen studentët e shkëlqyer.
2. Në rregulloret përkatëse të studimit përcaktohen kriteret që duhet të plotësohen për t'u pranuar në një program të dytë studimi.

Neni 62
Kodifikimi i programeve të studimit.

1. Kodifikimi i programeve të studimit kryhet brenda një viti nga hyrja në fuqi e Statutit. Të gjitha programet e miratuara deri në hyrjen në fuqi të Kodit të Programeve të Studimit riorganizohen dhe kodifikohen sipas LAL-së dhe akteve nënligjore.
2. Hapja e një programi të ri studimi shoqërohet me përcaktimin e kodit, sipas fushës së studimit dhe klasifikasiave të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe kodifikohen, sipas përcaktimeve të LAL-së dhe akteve nënligjore përkatëse.

Neni 63
Transferimi i studimeve.

1. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërtë dhe vetëm në fillim të vitit akademik.
2. Kriteret e procedurat e njohjes të krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloret përkatëse të studimeve miratuara nga Senati dhe në rregulloren e njësisë bazë, në përputhje me këtë ligj dhe akte të tjera nënligjore.
3. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, më qëllim vazhdimin e studimeve në USH, i takon komisionit përkatës, të ngritur nga njësia bazë.

Neni 64
Njohja dhe njësimi i periudhave të studimit

1. USH ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtë institucion apo institacioneve të ndryshme të arsimit të lartë.

2. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucionë të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.

Neni 65
Kohëzgjatja e studimeve

1. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyvjeti i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

2. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër dhe u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të USH-së.

3. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të USH-së që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e studimeve dhe në rregulloren e saj.

Neni 66
Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës

1. Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.

2. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, dhe të ciklit të tretë shoqérohen me suplementin e diplomës.

3. Çdo formë diplome dhe certifikate, përpara se të lëshohet nga USH, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe në regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.

4. USH nuk lëshon dublikatë diplome, por mund të lëshojë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbyajë emrin e institucionit që ka lëshuar diplomën, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit.

5. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Ai pëershkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohet në statutin e USH-së nga Senati Akademik në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

KREU VII
KËRKIMI SHKENCOR

Neni 67
Kërkimi shkencor

1. USH është e lirë të kryejë kërkim shkencor, studime, projekte dhe veprimitari të tjera krijuar me synim rrithjen e cilësisë së veprimitarisë akademike me fondet e buxhetit të shtetit, nga granti i punës kërkimore-shkencore, që sigurohet përmes projekteve të paraqitura në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe nga fondet e veta.

2. USH ka të drejtë të hartojë programe dhe projekte kërkimore në bashkëpunim me institucionë

të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit.

3. USH-ja tregon të drejtën e përsitimit të fondeve publike për projektet e studimeve të doktoratës.
4. USH-ka tregon të drejtë të krijojë institute dhe qendra ndërinstitucionale të kërkim-zhvillimit me marrëveshje me IAL-të ose me institucione kërkimore-shkencore, kulturore dhe ekonomike, publike e private me miratim të Këshillit të Ministrave. Funksionimi i tyre përcaktohet në rregulloren e tyre, në përputhje me statutet e institucioneve themeluesc.
5. Senati Akademik identifikon dhe përcakton fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit për vitin akademik.
6. Të drejtën për të përsituar fonde për kërkim shkencor e kanë fakultetet, departamentet, personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në USH dhe studentët e ciklit të dytë dhe të tretë të USH-së.

Neni 68 **Financimi i kërkimit shkencor**

1. Fakultetet, departamentet, personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në USH dhe studentët e ciklit të dytë e të tretë mund të aplikojnë me projekte pranë njësisë përkatëse të Drejtorisë së Kurrikulave dhe kërkimit shkencor.
2. Kriteret për përfitimin e financimeve për punën kërkimore shkencore miratohen nga Senati për çdo vit akademik dhe shpallen në rektorat, fakultete dhe në faqen përkatëse zyrtare online të USH-së.
3. Rektori përcakton projektet fituese. Kontrata hartohej ndërmjet drejtuesit të projektit dhe Rektorit.

Neni 69 **Kërkimi shkencor për të tretë**

1. USH, fakultetet, departamentet dhe personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në USH mund të ofrojnë, nëpërmjet veprimitarive kërkimore-shkencore, të zhvillimit dhe veprimitarive krijuese, shërbime për të tretë.
2. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë mund të ofrojnë shërbime për të tretë me kusht që të plotësojë të gjitha detyrimet individuale apo të njësisë përbërëse për kërkim shkencor ndaj USH-së.
3. Të ardhurat nga këto veprimitari administrohen nga USH, nga njësia kryesore ose njësia bazë që realizon veprimitarinë, sipas përcaktimeve të LAL-së dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU VIII **AUTONOMIA FINANCIARE**

Neni 70 **Autonomia finanziare**

1. USH-së funksionon sipas parimit të autonomisë finanziare. USH është autonom në sigurimin dhe përdorimin e të ardhurave finanziare.
2. Buxheti vjetor i USH-së hartohej sipas njësive shpenzuese dhe autonome në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
3. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga USH dhe njësitë përbërëse përdoren prej tyre. Pjesa e papërdorur e të ardhurave imbartet në vitin pasardhës.

4. Mënyra e përdorimit të të ardhurave nga USH dhe njësitë përbërëse përcaktohet në rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin.

Neni 71

Hartimi i buxhetit

- 1. Buxheti vjetor i USH-së hartohet nga Administratori i Universitetit mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë duke u mbështetur në planin buxhetor afatmesëm 2-vjeçar dhopplanin strategjik të Universitetit.**
- 2. Plani buxhetor vjetor dhe ai afatmesëm i USH-së miratohet paraprakisht nga Senati Akademik.**
- 3. Bordi i Administrimit të USH-së me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe afatmesëm të Universitetit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.**
- 4. Hartimi i buxhetit bëhet në përputhje me standarde vendosura nga Ministria e Financave.**
- 5. Buxheti i miratuar i USH-së i përcillet Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i cili brenda 30 ditëve ushtron kontrollin që i takon, sipas ligjit në formën e kërkesës së motivuar për rishikim.**

Neni 72

Burimet e financimit

- 1. Burimet e financimit të USH-së janë :**
 - a) Buxheti i Shtetit;**
 - b) Pagesat e studentëve për arsimim;**
 - c) Të ardhurat për shërbimet e kryera;**
 - d) Të ardhurat e krijuara nga palët e treta;**
 - e) Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi.**
- 2. Të ardhurat e përfituar nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore –shkencore, konsulencat si dhe çdo e ardhur tjetër që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik ndahet ndërmjet personelit akademik dhe Universitetit, sipas rregullores së miratuar nga Bordi i Administrimit.**
- 3. USH ka të drejtën e marries së kredive për zhvillimin e tij institucional dhe infrastrukturor, sipas kushteve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.**
- 4. Pronat e paluajtshme, në të cilat ushtron veprimtarinë USH-ja, kalojnë në administrim të USH-së, me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për arsimin. USH ka detyrimin të ruajë dhe të mirëmbajë pronat në administrim dhe nuk mund të ndryshojë destinacionin e tyre.**
- 5. USH mund të zhvillojë pronat e veta me miratimin paraprak të subjektit që i ka kaluar pronën në administrim.**
- 6. Rregullorja "Për mënyrën e përdorimit të londeve të krijuara nga të ardhurat e veta" pas miratimit paraprak nga Senati Akademik miratohet nga Bordi i Administrimit i USH-së. Kjo rregullore bazohet në LAL dhe në të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore për menaxhimin financiar.**


Neni 73

Kontrolli dhe auditimi

- 1. USH i nënshtron auditit financiar të brendshëm dhe të jashtëm. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në USH dhe njësitë përbërëse të tij realizohet nga njësia e auditimit të brendshëm të USH-së. (Referencë Neni 116)**
- 2. Njësia e auditit të brendshëm funksionon duke u bazuar në rregulloren e saj në ligjin e arsimit**

të lartë dhe në legjislacionin përkatës për auditimin.

3. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm në USH kryhen nga auditues të brendshëm ose të jashtëm, të përzgjidhur nga MASR prej listës së përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave.
4. Rezultatet e kontrollit dhe auditit bëhen publike.



KREU IX

MARRËDHËNIET ME JASHTË

Neni 74 Marrëdhëniet me jashtë

USH ka të drejtën për të lidhur marrëveshje me institucione, persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimitarive mësimdhënëse, kërkimore - shkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera të ligjshme.

Neni 75 Qendrat studimore ndërdisiplinore

1. Për interesa të përbashkëta studimore, kërkimore dhe zhvillimore, njësitë kryesore përbërëse të USH-së, mund të krijojnë në bashkëpunim qendra studimore ndërdisiplinore.
2. Struktura e qendrës studimore ndërdisiplinore, përbërja, funksionimi, drejtimi i saj përcaktohen në statutin dhe në aktet e krijimit.

KREU X

VEPRIMTARIA BOTUESE

Neni 76 Veprimtaria botuese e USH-së

1. USH ka organin e vet periodik shkencor “Buletinin shkencor”, i cili botohet në disa seri të ndryshme. Çdo scri drejtohet nga redaksi të veçanta, që miratohet nga Rektori. Rektori është drejtori i revistës.
2. Me plotësimin e kushteve USH ka të drejtën e krijimit të shtëpisë së vet botuese.

KREU XI

STUDENTËT

Neni 77 Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit

1. Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në një program studimi të USH-së. Ky status humbet me marrjen e diplomës ose certifikatës përkatëse, si dhe në rastin e çregjistrimit të studentit.

2. Studenti mund t`i pezullojë studimet dhe t`i rifillojë ato, në përputhje me rregullat e përcaktuara në rregulloren e studimeve në USH.

3. Studenti nuk mund të regjistrohet njëkohësisht, në më shumë se një program studimi. Bëjnë përfjashtim nga ky nen nxënësit dhe studentët e shkëlqyer.

Neni 78

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

1. Studentët kanë të drejtë:

- a) të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku ata janë regjistruar; leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tyre;
- b) të përdorin infrastrukturën, që USH vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen nga institucioni;
- c) të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes të USH-së, në përputhje me përcaktimet e LAL dhe statutin e USH-së;
- d) të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në USH;
- e) të përsaqësohen në organet drejtuese të USH-së në Senatin Akademik sipas përqindjeve të caktuara në ligj dhe komisionet e përhershme sipas LAL-së dhe statutit.
- f) të organizohen në shoqata studentore (mbi baza jopolitike, jofetare apo joetnike), duke iu përmbytj përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse;
- g) të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe stimuj materialë për rezultate të shkëlqyera.

2. Studentët janë të detyruar:

- a) të zbatojnë rregullat e përcaktuara në statutin e USH-së dhe në të gjitha rregulloret dhe kodin e etikës së USH-së;
- b) të marrin pjesë në veprimtaritë akademike të organizuara nga departamenti, fakulteti apo universiteti;
- c) të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjérë;
- d) të paguajnë tarifat e përcaktuara për ndjekjen e studimeve dhe nga USH, si dhe tarifat e shërbimeve që u ofron USH;

3. Studentit përsëritës i ndërpritet mbështetja nga fondet publike, me përfjashtim të rasteve të forcave madhore.

Neni 79

Vlerësimi moral për studentët

1. Studentët që në përsundim të studimeve të plota, kanë të gjitha notat dhjeta, fitojnë "Medalje të Arte" me certifikatën përkatëse; ata që kanë jo më pak se 80% të notave dhjeta e pjesën tjetër nënta, fitojnë certifikatën "Student i Shkëlqyer".

2. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni në çdo fakultet; për studentët që fitojnë "Medalje të Arte" ose certifikatën "Student i Shkëlqyer", ceremonia organizohet në shkallë Universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori, në prani të përsaqësuesve të Senatit, të profesoratit, të administratës dhe të studentëve.

3. Për arritje të veçanta në fushën e sporteve, artit, kulturës, shkencës, si dhe në ndihmë të komunitetit studentët vlerësohen me "Certifikatën e mirënjosjes".

Neni 80 Këshilli i studentëve

1. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në USH, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike.
2. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore në nivel njësie kryesore dhe universiteti.
3. Këshillat studentore promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të USH-së.
4. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Kur individi i zgjedhur në këshillat e studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur.
5. Këshillat e studentëve nuk mund të përfshihen në struktura të tjera politike e jopolitike jashtë USH-së.
6. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të USH-së, për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimitarive të ndryshme kulturore, artistike dhe sportive.
7. USH mbështet këshillat e studentëve dhe financon veprimitari të tyre në përputhje me statutin dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 81 Karta e studentit

1. Studentët e USH-së pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.
2. Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit përcakton kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit.
3. Përsitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të ministrisë përkatëse që mbulon institucionin e arsimit të lartë ose njësive të qeverisjes vendore të cilat mbulojnë shërbimet e ofruara ndaj studentëve.
4. Kategoritë e shërbimeve që ofrojnë entet shtetërore bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentore e me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.

Neni 82 Dokumentacioni i procesit mësimor

1. Regjistri themeltar i studentëve është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në USH.
2. Çdo student pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, i cili pasqyrohet në këtë regjistër. Regjistri plotësohet edhe në formë elektronike.
3. Regjistri i arritjeve akademike është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në USH, sipas programeve të studimit.
4. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave është dokumenti që vërteton lëshimin e tyre prej USH-së. Regjistrat plotësohen e dhe në mënyrë elektronike.
5. Gjithë dokumentacioni, pas plotësimit përfundimtar të tij, depozitohet në arkivat e shtetit.

ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet në arkivin e USH-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e institucionit.

6. Në rastin e mbylljes së veprimtarisë së USH-së, regjistrat dhe çdo dokument tjetër, depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat.

Neni 83

Baza e të dhënave të studentëve në institucionet e arsimit të lartë

1. USH detyrohet të ruajë të dhënat personale të studentëve sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

2. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga USH bazohen në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU XII

CEREMONITË

Neni 84

Organizimi i ceremonive

1. Në USH organizohen ceremoni të ndryshme sipas rastit. Ndër ceremonitë e përhershme që zhvillohen në USH janë :

- a) Përvjetorët jubilarë të krijimit të USH-së;
- b) Dorëzimi i titujve e gradave shkencore;
- c) Fillimi i vitit akademik;
- d) Dorëzimi i diplomave të studentëve;
- e) Dorëzimi i titullit “*Doktor Honoris Causa*”;
- f) Dorëzimi i titujve të nderit që lëshon USH.

2. Në raste solemne akademike autoritetet drejtuese të USH-së përdorin veshje ceremoniale.

3. Organizimi dhe zhvillimi i ceremonive bëhet duke ndjekur të gjitha procedurat e protokollit të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

KREU XIII

EMRI, VULA DHE STEMA ZYRTARE

Neni 85

1. Këshilli i Ministrave me vendimin e nr. 167, datë 28 maj 1991 përcaktoi emrin zyrtar të Universitetit “Universiteti i Shkodrës “Luigj Guarkuqi”

2. Statuti i USH-së përcakton vulë zyrtare të USH-së atë të paraqitur në (Modeli 1 në faqen 46)

3. Statuti i USH-së përcakton simbol zyrtar të USH-së stemën e paraqitur në (Modeli 2 në faqen 47)

4. Ndryshimi i emrit dhe i stemës të USH-së bëhet vetëm me vendim të Senatit Akademik. Për këto ndryshime USH detyrohet të njoftojë ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë.

KREU XIV



MIRATIMI DHE RISHIKIMI I STATUTIT

Neni 86

Miratimi dhe rishikimi nga Senati Akademik

1. Statuti i USH-së miratohet nga Senati Akademik me votat e 2/3 të gjithë anëtarëve të tij, pasi te jetë marrë miratimi paraprak me votat e 2/3 të gjithë anëtarëve të Bordit të Administrimit.
2. Rishikimi i Statutit të USH-së dhe çdo ndryshim në statut miratohet nga Senati Akademik, sipas parishikimi të pikës 1 të këtij neni.
3. Subjektet që gëzojnë të drejtën të propozojnë ndryshime të pjesshme ose rishikimin e plotë të Statutit të USH-së janë: rektorati i USH-së, 5 (pesë) anëtarë të Senatit Akademik dhe 50 (pesëdhjetë) anëtarë të asamblesë akademike të USH-së.

Neni 87

Hyrja në fuqi

1. Statuti i USH-së konsiderohet i miratuar ditën kur Ministri përgjegjës për arsimin nxjerr aktin përkatës me të cilin shprehet se miraton Statutin e USH-së.
2. Kur Ministri konstaton mospërputhje të Statutit me ligjin ia kthen për rishqyrtim SA-së, i cili brenda 5 ditëve nga kthimi, rishqyron dhe miraton ndryshimet e propozuara nga ministri.
3. Statuti i USH-së konsiderohet i miratuar në mënyrë të heshtur brenda dy muajve kur ministri nuk shprehet për miratimin ose jo të statutit, siç përcaktohet në LAL.
4. Statuti i USH-së, i miratuar sipas procedurave ligjore të mësipërme, hyn në fuqi ditën që shpallet nga Rektori i USH-së.

KREU XV

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 88

Miratimi i rregulloreve

1. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij Statuti, Senati Akademik i USH-së harton dhe miraton rregulloren e Senatit.
2. Rregullorja e rektoratit hartohejt nga Rektori dhe miratohet nga rektorati.
3. Rregulloret e fakulteteve hartohejnë nga dekanatet dhe miratohen nga Senati Akademik:
4. Rregullorja e Bordit të Administrimit hartohejt dhe miratohet nga vetë Bordi.
5. Rregullorja e brendshme e administrimit të financave dhe të kontabilitetit, hartohejt nga administratori i USH-së dhe miratohet nga Senati Akademik dhe Bordit i Administrimit.
6. Rregullorja Komisionit të Përherershëm për Promovimin e Personelit Akademik të USH-së, miratohet nga Senati Akademik.
7. Rregullorja e Këshillit të Etikës hartohejt nga ky këshill dhe miratohet në Senatin Akademik.

Miratuar nga Senati Akademik me Vendimin nr.52, datë 21.02.2025 "Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Shtoja 1

